



Në bazë të nenit 26 paragrafit 1 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ nr 043/20 dhe 43/23) e në lidhje me nenin 10 Paragraf 3 i Vendimit mbi bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“, nr 047/22 prej më 04.10.2022), e në propozim Vendim të Komisionit për ndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancim të projekteve nga fusha e kulturës nr.04-633/23-2721/2 prej më 24.04.2023. sekretarja e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale sjell :

Vendimi

Për shpërndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancim të projekteve nga fusha e kulturës për vitin 2023.

I

Mjetet në vlerë prej 6,000.00 euro, të destinuara për shpërndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancim të projekteve në fushën e kulturës për vitin 2023. nr. 04-633/23-304 prej më 17.01.2023. si në vazhdim:

Emri dhe mbiemri	Fusha konkurente	Emri i projektit	Shuma
1. Samir Bećaj	Veprimtari muzikore dhe skeniko-muzikore	CD me këngë burimore shqipe dhe instrumental pjesa e II	2.000,00€
2. Nikoll Lucgjonaj	Artet e bukura dhe aktivitetet ekspozuese	“Malësia pasioni im”	1.500,00€
3. Veronika Dedvukaj	Përkthim letrar	Përkthimi në anglisht i romanit “Humbja” – “The Loss”	900,00€
4. Kristjan Gjokaj	Përkthim letrar	Përkthimi në gjermanisht i romanit “Fshati i heshtjes”	900,00
UKUPNO			5.300,00€

II

Pjesëmarrësi i konkursit që nuk i plotëson kushtet për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës për vitin 2023:

Ime prezime	Oblast za koju konkuriše	Naziv projekta	Iznos
1. Monika Dukaj	/	Festivali Ndërkombëtar I filmit për fëmijë "Ani Fest Tuz"	/

III

Organi kompetent dhe zbatues i projektit, në bazë të Vendimit për bashkëfinancim, lidhin Kontratën për bashkëfinancim të projektit.

IV

Zbatuesi i projektit është i obliguar që mjetet e paguara nga buxheti i komunës t'i shfrytëzojë ekskluzivisht për qellimet e miratuara në realizimin e projektit.

V

Vendimi për shpërndarjen shpallet publikisht dhe publikohet në faqen zyrtare të komunës.

VI

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit.

Arsyetim

Neni 9 i Vendimit për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës („Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“ nr.047/22) përcakton se vlerësimi i projekteve të paraqitura në konkurs bëhet nga Komisioni për shpërndarjen e mjeteve, Komisioni i përbër nga kryetari dhe katër anëtarë, i formuar nga eprori i organit kompetent.

Neni 10 i këtij Vendimi përcakton se Vendimin për shpërndarjen e mjeteve për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës merret brenda 40 ditëve nga perfundimi i konkursit.

Neni 10 i këtij Vendimi gjithashtu përcakton se Vendimin për shpërndarje e merr eprori i organit kompetent me propozimin e Komisionit nga neni 9 i këtij Vendimi.

Në bazë të Nenit 1 të këtij Vendimi përcaktohen kushtet, mënyra, kriteret dhe çeshtjet tjera që kanë të bëjnë me bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës.

Sekretariati për vetëqeverisje lokale i Komunës së Tuzit shpalli Konkursin publik për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës për vitin 2023 nr.04-633/23-304 data 17.01.2023 dhe e publikoi atë përmes shtypit, mediave, në faqem e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me si dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Tuzit.

Në bazë të nenit 7 të paragrafit 1 të Rregullores së punës së Komisionit, Komisioni shqyrton të gjitha aplikimet e mbrrira në konkurs. Pas vlerësimit të projekteve të paraqitura në konkurs, komisioni vendosi një listë të aplikimeve që plotësojnë kërkesat e konkursit publik për vitin 2023.

Komisioni për shpërndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës për vitin 2023.shqyrtoi aplikimet paraqitura dhe duke zbatuar kriteret e përcaktuera me Rregullore sielli Propozim vendimin nr.04-633/23-1928/2 prej më 24.04.2023. , dhe ja propozoi eprorit të organit kompetent që të marrë Vendim për shpërndarjen e mjeteve.

Më Propozim Vendimin për shpërndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës, me numer 04-633/23-1928/2 data 24.03.2023. Komisioni për ndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës u dorëzoi pjesëmarrësve të konkursit Propozim Vendimin për shpërndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës, për të cilën pjesëmarrësit e Konkursit Publik, ku kishin të drejtë të parashtronin kundërshtime në propozimin e Komisionit brenda 8 ditëve nga dorëzimi i Propozimit.

Në propozimin e lartëpërmendur, Monika Dukaj ka paraqitur ankesë nr.1928/2 datë 03.04.2023., duke kërkuar nga Komisioni të shqyrtojë edhe një herë Propozim Vendimin për shpërndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës. Në ankes thekësohet se projekti Festivali Ndërkombëtar i Filmit për Fëmijë “Ani Fest Tuz” i përket fushës së shpallur në konkurs, përkatësisht : Artet e bukura dhe aktivitetet ekspozuese.

Komisioni për ndarjen e mjeteve në bazë të konkursit për bashkëfinancim të projekteve nga fusha e kulturës, në seancën e mbajtur më 14 prill 2023, shqyrtoi Ankesën e Monika Dukaj, pas së cilës konstatoi se kundërshtimi ishte i pabazë dhe se nuk ka vënë në dyshim rregullsinë e fakteve të konstatuara nga Komisioni, të cilat janë konstatuar dhe në Procesverbalin nr.04-633/23-1928/5 datë 17.04.2023.

Komisioni deklaroi se projekti Festivali Ndërkombëtar i Filmit për Fëmijë “AniFest Tuz”, nuk i përket asnjërës nga fushat e shpallura të Konkursit, përkatësisht: Veprimtaritë e artit figurativ dhe ekspozitës, Veprimtari botuese, Përkthim letrar, Veprimtari skenike muzikore.

Neni 6 paragrafi 2 i Vendimit për bashkëfinancimin e projekteve nga fusha e kulturës (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi”, nr.047/22), përcakton se personat fizikë mund të konkurrojnë me projekte që ata i realizojnë në menyrë të pavarur si vepra e tyre e autorit. Në lidhje me këtë Komisioni konstatoi se projekti Festivali Ndërkombëtar i Filmit për Fëmijë “AniFest Tuz”, nuk konsiderohet si projekt që do të realizohej në mënyrë të pavarur si e drejtë e autorit.

Pas shqyrtimit të Propozim Vendimit, Sekretaria e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale mori Vendim për ndarjen e mjeteve për bashkëfinancimin e projekteve në fushen e kulturës për vitin 2023.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të ketij Vendimi.

SEKRETARE,

Marina Ujkaj



Dosrëzohet:

- Lënda
- a/a